

PROFILI PEDAGOGJIK DHE SHKENCOR I PROF. DR. ALI JASHARIT

Ali Jashari, gjuhëtar e profesor, u lind në fshatin Çipan të Devollit më 20 qershor 1953. Pas shkollës së mesme në Bilisht, kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës dhe u diplomua në degën Gjuhë shqipe-letërsi në vitin 1977.

Në vitin 1991 mbron gradën “Kandidat i shkencave filologjike” me tezën “*Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërim*” (me ekuivalentimin e gradave shkencore, në vitin 1994, merr gradën “Doktor i shkencave”); në vitin 1999 fiton titullin “Profesor i asociuar”, ndërsa më 2004 titullin “Profesor”.

Fusha kryesore e studimeve të prof. Ali Jasharit është leksikologjia, semantika dhe më ngushtë frazeologjia. Ai ka bërë disa kualifikime jashtë vendit, si: në Universitetin “Aristoteli” të Selanikut (gjuhësi ballkanike); në “North London” të Londrës, për metodologjinë e mësimdhënies; në Universitetin e Oxfordit për kërkime në fushën e idiomatikës angleze e gjuhësinë moderne; në Aarhus, Danimarkë, për gjuhësinë kompjuterike e didaktikë mësimore; në Universitetin e Bolonjës për arsimin gjithëpërfshirës etj.

Prof. Ali Jashari ka dhënë leksione për gjuhën shqipe në Fakultetin e Edukimit në Prizren (2000-2002), në Universitetin “Neofit Rilski”, Bllagojegrad, Bullgari (2004, 2008) dhe në Universitetin “St. Klement Ohridski”, Sofje, dega e ballkanistikës (2010). Në vitin 2003 merr titullin “*Trajnues ndërkombëtar për të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit*”.

Ai ka punuar mësues në shkollën e mesme, Miras (Devoll), specialist i gjuhës shqipe në Kabinetin Pedagogjik (Korçë) dhe mësues në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja në Korçë. Nga viti 1996 e vazhdim është pedagog i gjuhësisë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin “Fan Noli” të Korçës, ka hartuar programe mësimore dhe është lektor e titullar i lëndëve: Formim gjuhësor, Analizë semantike, Leksikologji, Gjuhësi e përgjithshme, Morfologji e gjuhës shqipe, Filozofi e gjuhës etj.

Prof. Jashari është pedagog i ftuar për leksione në disa universitete të Shqipërisë dhe udhëheqës shkencor i mbi 10 doktoraturave.

Prof. Ali Jashari ka tregues të lartë në fushë të botimeve të teksteve shkollore, si dhe librave universitarë, si: 1. *Libri i gjuhës shqipe*, 3 (për shkollat e mesme), ShBLSH, Tiranë, 1979 (bashkautor); 2. *Libri i gjuhës shqipe* 1, 2, 3, 4 (për shkollat pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja), SHBLSH, Tiranë, 1984-1995 (bashkautor); 3. *Ushtrime për leksikologjinë e gjuhës shqipe*, ShBLU, Tiranë, 1991; 4. *Gjuha shqipe* 5 (për shkollat e minoritetit), ShBLSH, Tiranë, 1995; 5. *Gjuha shqipe për studentë*, Kotti, Korçë, 1998; 6. *Një libër dore për gjuhën shqipe*, AEDP, Tiranë, 1999; 7. *Praktikum për drejtshkrimin e shqipes*, Kotti, Korçë, 2000; 8. *Analiza semantike*, Kotti, Korçë, 2001; 9. *Gjuhësi e zbatuar* 1, 2, Kotti, Korçë, 2003; 10. *Doracak për*

gjuhën shqipe, Korçë, 2006 (bashkautor); 11. *Formim gjuhësor 1, 2*, Silver, Elbasan, 2007(bashkautor); 12. *Krestomaci për gjuhësinë e përgjithshme*, Kotti, Korçë, 2007; 13. *Gramatikë e gjuhës shqipe* (për studentët e gjuhëve të huaja), Prishtinë, 2009; 14. *Gjuha shqipe dhe letërsia 10*, Tiranë, 2010 (bashkautor); 15. *Gjuhë amtare*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2010, 2011 (bashkautor); 16. *Gjuha shqipe për klasat 6, 8, 9*, Uegen, Tiranë, 2012 (bashkautor); 17. *Morfologji e zbatuar*, Prishtinë, 2013 etj.

Libra të tjerë:

1. *Filli i Arianës* (fjalorth me shprehje latine etj.), Kotti, Korçë, 1995; 2. *Për gjuhën shqipe dhe mendimin kritik*, Tiranë, 1999; 3. *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërime* (monografi), Kotti, Korçë, 2000; 4. *Gjedhe mësimdhënieje përmes teksteve për shqipen*, Kotti, Korçë 2000; 5. *Përsiatje për gjuhën shqipe*, Kotti, Korçë, 2003; 6. *Anketimi dhe ekspeditat gjuhësore*, Kotti, Korçë, 2007 (bashkautor); 7. *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2007; 8. *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008 (bashkautor); 9. *Scripta manent*, Promo Print Publishing House, Korçë, 2013; 10. *Fjalor leksiko-frazeologjik i krahinës së Devollit*, Promo Print Publishing House, Korçë, 2016. Ai është duke përfunduar Fjalorin e plotë të homonimeve të gjuhës shqipe dhe një monografi në gjuhën angleze për kallet dhe huazime frazeologjike.

Prof. dr. Ali Jashari ka botuar mbi 90 artikuj shkencorë dhe popullarizues në revistat “Studime filologjike”, “Gjuha jonë”, “Nëntori”, “Kultura popullore”, “Mprehtësi”, “Malësia”, “Scupi”, Buletini Shkencor i Universitetit “Fan Noli”, “Tempulli”, si dhe në organe të tjera jashtë vendit (anglisht, bullgarisht etj.) dhe ka marrë pjesë me kumtesa për gjuhësinë dhe mësimdhënien në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. dr. Ali Jashari është organizator dhe bashkorganizator i disa veprimtarive shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare që janë organizuar në Universitetin e Korçës dhe kryeredaktor i botimeve përkatëse, si: “*Nga ëvetarët e Naum Veqilharxhit te Kongresi i Manastirit*”, 14 nëntor 2008 (me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit); “*Profesor Selman Riza dhe albanologjia*”, 4 dhjetor 2009 (me rastin e 100-vjetorit të lindjes), “*Akademiku Jani Thomai në 75-vjetorin e lindjes*”, Korçë, 20-21 maj 2010; *Konferencë kushtuar shkrimtarit dhe akademikut Dritëro Agolli me rastin e dhënies së titullit “Doctor Honoris Causa*”, Korçë, tetor 2011; “*Hafiz Ali Korça-55 vjet pas (1873-1956)*”, Korçë, 21-22 dhjetor 2012; “*Fan S. Noli në 130-vjetorin e lindjes*”, Korçë, 2012; “*Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*”, Korçë, 16-17 nëntor 2012; “*Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune*”, Korçë, 26-27 mars 2013; Konferencë shkencore kushtuar gjuhëtarit dhe profesorit Dhimitër Samara”, Korçë, 23 maj 2014; *2nd International Conference (Education Across Borders) “Critical Thinking in Education*”, 31 October-1 November 2014, Korçë; “*Konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos në 195-vjetorin e lindjes*”, Korçë, 25-26 mars 2015; “*Konferencë shkencore kushtuar jetës dhe veprës së Athanas Tashkos*”, Korçë 13 nëntor 2015, disa prej të cilave janë organizuar në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë

vendit, si Bashkia e qytetit të Korçës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Edukimit në Follorinë, Greqi, Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Bitolas, Maqedoni etj., ku kanë marrë pjesë personalitete të shquara të shkencës, si: akad. Dritëro Agolli, akad. Teki Biçoku, akad. Jani Thomai, akad. Jorgo Bulo, akad. Kolec Topalli, akad. Gjovalin Shkurtaç, akad. Floresha Dado, akad. Françesko Altimari, prof. dr. Matteo Mandala, prof. Giovanni Belluscio, prof. Victor Fridman, akad. Grigore Brankush, akad. Nikolae Saramandu, prof. dr. Andreë Goodspeed, prof. dr. Xhevat Lloshi, prof. dr. Shezai Rrokaj, prof. dr. Emil Lafe, prof. dr. Nasho Jorgaqi, prof. dr. Rami Memushaj, prof. dr. Dhimitri Bello, imzot Johan Pelushi, Prof. dr. Bardhyl Musai, prof. dr. Valter Memishaj, prof. dr. Dhurata Shehri, prof. dr. Ymer Çiraku, prof. dr. Abdulla Ballhysa, prof. dr. Shefkije Islamaj, prof. dr. Qemal Murati, prof. dr. Hamit Xhaferi, prof. dr. Begzad Baliu e shumë të tjerë.

Prof. dr. Ali Jashari përgjatë tetë viteve të fundit ka organizuar disa veprimtari për përrurimin e librave të personaliteteve të ndryshme, lektoriume, biseda etj., si Amik Kasoruh, Adem Demaçi, Teodor Laço, Ben Blushi, Skënder Rusi, Hysen Koçillari, Andon Andoni, prof. Roberto Dainese, prof. Federica Zanetti etj. Gjithashtu, prof. Jashari ka ndihmuar në gjallërimin e jetës studentore duke mbështetur të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Këshilli i Studentëve.

Prof. Ali Jashari në nëntor-dhjetor të vitit 1991 ka qenë drejtues i grupit të punës së Komitetit Ekzekutiv të Stabilitetit të asaj kohe për hartimin e platformës dhe propozimit për hapjen e Universitetit të Korçës (janar 1992).

Prof. dr. Ali Jashari është drejtues i revistës “*Vjetari shkencor-FEF*”, botim i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Në vitet 2000-2008 ka qenë sekretar shkencor i Buletinit Shkencor të Universitetit “Fan Noli” dhe në vijim anëtar i Këshillit Botues, për disa vjet përgjegjës i departamentit të edukimit të përgjithshëm dhe më pas përgjegjës i departamentit të gjuhës dhe të letërsisë; në vitet 2008-2011 zëvendësrektor i Universitetit “Fan S.Noli”, anëtar i Senatit Akademik të Universitetit, anëtar dhe kryetar i Këshillit të Profesorëve, ekspert i jashtëm i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, ndërsa në vitet 2012-2016 ka kryer detyrën e dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.